



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



BULETINI DITOR I FSSHM-së

PËRMBLEDHJE INFORMACIONESH NGA LËMIA E SHËNDETËSISË TË MARRA NGA SHTYPI DITOR DHE MEDIUMET ELEKTRONIKE

05 Janar 2016



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Koha
E PËRDITSHME INFORMATIVE

Fondi shëndetësor me buxhet rekord



Fondi për sigurim shëndetësor vitin 2016 do ta fillojë me një buxhet të rritur historik prej 25,6 miliard denarë. Krahasuar me vitin e kaluar, rritja shënon vlerën prej 1,4 miliardë denarë dhe krahasuar me vitin 2000, bëhet fjalë për pothuajse rritje të dyfishtë.

“Për shpërndarje të drejtë dhe transparente të buxhetit, dy muajt e kaluar kemi zhvilluar negociata me personelin e sistemit shëndetësor dhe kemi bërë shpërndarjen metodologjike mes institucioneve shëndetësore publike dhe private. Negociatat janë praktikuar ndryshe nga herrat tjera, gjegjësisht ato janë zhvilluar në hapësirat e vetë institucioneve shëndetësore dhe disa edhe në Fond. Për shpërndarjen e buxhetit, Fondi bazohet në të dhënat e institucioneve shëndetësore dhe në analizat e realizimit të buxhetit në vitin 2015, Planin për llojin dhe fushëveprimin e shërbimeve shëndetësore, metodat e reja, shërbimet e reja shëndetësore për vitin 2016 (për të cilat shërbime të siguruarit janë dërguar të mjekohen jashta vendin) si dhe qëndrueshmëria e institucioneve shëndetësore publike”, thuhet në njoftimin e FSSH-së.



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



lajm
MAQEDONI

Buxheti i Fondit për sigurim shëndetësor për vitin 2016



Fondi për sigurim shëndetësor vitin 2016 do ta fillojë me një buxhet të rritur historik prej 25,6 miliard denarë. Krahasuar me vitin e kaluar, rritja shënon vlerën me 1,4 miliard denarë respektivisht, krahasuar me vitin 2000 kemi pothuajse rritje të dyfishtë.

Për shpërndarje të drejtë dhe transparente të buxhetit, dy muajt e kaluar kemi zhvilluar negocijata me personelët e sistemit shëndetësor dhe kemi bërë shpërndarjen metodologjike mes Institucioneve shëndetësore publike dhe private. Negocijatat janë praktikuar në një mënyrë më ndryshe se herave tjera gjegjësisht, negocijatat janë mbajtur në hapësirat e vetë Instituconeve shëndetësore e disa prej tyre dhe në Fond. Për shpërndarjen e buxhetit, Fondi bazohet në të dhënat e Institucioneve shëndetësore dhe në analizat e realizimit të buxhetit në vitin 2015, Planin për llojin dhe fushëveprimin e shërbimeve shëndetësore, metodat e reja, shërbimet e reja shëndetësore për vitin 2016 (për të cilat shërbime të siguruarit janë dërguar të mjekohen jashta vendin) si dhe qëndrueshmëria e Institucioneve shëndetësore publike.



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Shpërndarja e përgjithshme e mjeteve për vitin 2016 qëndron si në vijim:

Mjetet për vitin 2016

Shpenzimet	(të shprehura në 000 denarë)	Përqindja
Institucionet shëndetësore publike	13,746,599	54 %
Institucionet shëndetësore private (prej të cilave):	7,813,500	31 %
Mjekët amë	2,785,000	
Barnatoret	2,480,000	
Specialistët dhe Laboratoritë	610,000	
Dijaliza	1,000,000	
In – vitro	95,000	
Kardiokirurgjia	705,000	
Kirurgjia e syve	65,500	
Banjat	73,000	
Mjekimet jashta vendit	300,000	1 %
Paisjet ortopedike	550,000	2 %
Refundimet	50,000	
MANU	17,000	
Kompensimet e pushimeve mjekësore dhe të lindjes	2.575.000	10 %
Shpenzimet administrative të Fondit	573,078	2 %
Gjithsej	25,575,177	

Gjatë shpërndarjes së buxhetit për vitin 2016, rritjen e mjeteve prej 860 milion denarë u'a kemi dedikuar Institucioneve shëndetësore publike, duke Ju dhënë përkrahje serioze dhe stimul më të madh.

Mjetet e dedikuara u përkasin disa segmenteve edhe atë:



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



- Shërbimeve të reja shëndetësore duke zbatuar metoda të reja për mjekim
- Rritjes së Llojit dhe fushëveprimit të shërbimeve shëndetësore egzistuese
- Qëndrueshmërisë financiare të Institucioneve shëndetësore dhe nevojës së financimit për funksionim
- Punësimeve të reja të stafit të specializuara
- Rritjes së pagave për të punësuarit mjekësor që u përkasin kategorive të caktuara

Shpërndarja e buxhetit nëpër Institucionet shëndetësore publike është përcaktuar si në vijim:

Nr	Lloji i shëndetësore	Institucioneve GJITHSEJ	Buxheti për vitin 2015	Buxheti për vitin 2016	Dallimi mes Buxhetit 2016 dhe 2015	Përqindja e rritjes %
1	Klinikat Universitare		4.559.342.000	4.820.242.000	260.900.000	5,72
2	Klinikat Spitalore, dhe Spitalet e përgjithshme		4.263.100.000	4.631.500.000	368.400.000	8,64
3	Spitalet speciale		1.144.200.000	1.202.400.000	58.200.000	5,09
4	Shtëpitë e shëndetit dhe Stacionet		2.036.398.000	2.129.598.000	93.200.000	4,58
5	Institutet dhe Fakulteti I mjekësisë		690.800.000	731.400.000	40.600.000	5,88
6	Qendrat e shëndetit publik		192.900.000	211.100.000	18.200.000	9,43
7	Qendra PET[1]			20.500.000	20.500.000	
	Gjithsej Institucionet shëndetësore publike		12.886.740.000	13.746.740.000	860.000.000	6,67353

Këtë vit për herë të parë ndajmë mjete për funksionimin e Insitucionit të ri shëndetësor, Qendra PET i cili do të ketë rëndësi të madhe në sistemin shëndetësor.

Rritja e buxhetit për Institucionet shëndetësore publike është motivuese me qëllim që të rritet vëllimi dhe kualiteti i shërbimeve shëndetësore. Rritja e mjeteve është e kushtëzuar me rritjen e numrit të intervenimeve kirurgjikale tek Klinikat dhe Spitalet e përgjithshme, duke synuar zvogëlimin e udhëzimeve që jepen drejt Klinikave të kryeqytetit.

Në vijim do të veçojmë disa nga Institucionet shëndetësore publike me buxhet të rritur:

Klinika Universitare e Kardiologjisë ka rritje prej 19,4 milion denarë respektivisht buxhet të përgjithshëm prej 342,4 milion denarëve;



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Klinika Universitare për Neurokirurgji ka rritje prej 9,9 milion denarë, buxhet të përgjithshëm prej 122,9 milion denarëve;

Klinika Universitare për Kirurgji torakale dhe vaskulare ka rritje prej 6,9 milion denarë, buxhet të përgjithshëm prej 112,4 milion denarëve;

Klinika universitare për traumatologji, sëmundje ortopedike, anestezion, reanimacion dhe mjekim intenziv-Qendra e urgjencës ka rritje prej 49,4 milion denarë, buxhet të përgjithshëm prej 443,9 milion denarëve;

Klinika universitare për hematologji ka rrite prej 19,9 milion denarë, buxhet të përgjithshëm prej 247,4 milion denarëve;

Klinika Universitare për radioterapi dhe onkologji ka rritje prej 24,4 milion denarë, buxhet të përgjithshëm prej 576,4 milion denarëve

Prej Spitaleve do ta veçojmë 8 Shtatorin me rritje prej 68,9 milion denarë, buxhet të përgjithshëm prej 829,9 milion denarëve;

Spitali Klinik i Shtipit ka rritje prej 19,9 milion denarë, buxhet të përgjithshëm prej 338 milion denarëve

Spitali Klinik i Manastirit ka rritje prej 19,9 milion denarë, buxhet të përgjithshëm prej 602 milion denarëve

Spitali Klinik i Tetovës ka rritje prej 29.9 milion denarë, buxhet të përgjithshëm prej 460 milion denarëve

Spitali i përgjithshëm Kumanovë ka rritje prej 48,9 milion denarë, buxhet të përgjithshëm prej 371,4 milion denarëve.

Spitali i përgjithshëm Gostivar ka rritje prej 45,9 milion denarë, buxhet të përgjithshëm prej 285,5 milion denarëve.

Spitali Klinik i Tetovës, Spitali i përgjithshëm Kumanovë dhe Spitali i përgjithshëm Gostivar kanë gjithsej rritje prej 123,7 milion denarë ose mbi 2 milion euro, respektivisht buxhet të përgjithshëm prej 1 miliard e 120 milion denarë.



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Buxheti i mbetur prej 1,4 miliard denarë (540 milion denarë) shpërndahet për furnizimin e barnatoreve me barna që jepen me receta, për rritjen e numrit të trajtimeve për dijalizë, për rritjen e numrit të procedurave in-vitro dhe lirimimin nga participimi i procedurave in-vitro që hyri në fuqi nga 13 Nëntori 2015, si dhe rritja e vlerës së kapitacionit të mjekëve të përgjithshëm amë dhe stomatologëve amë.

[1] Qendra për Tomografi të Emisionit Pozitron (Positron Emission Tomography)



Spitalet me buxhet më të madh

Shkup, 4 janar - Plot 1,5 miliardë denarë më shumë do të kenë institucionet shëndetësore për vitin 2016, paralajmëroi drejtori i fondit të sigurimit shëndetësor Sasho Stefanovski. Buxheti do të kap shumë prej 25 miliardë e 575 milionë denarësh dhe do të jetë më i madhi deri më tani.

“Këto mjete të rritura për 6,7% krahasuar me vitin 2015, i caktuam për disa segmente edhe atë, për shërbime të reja shëndetësore me futjen e metodave të reja mjekuese, rritjen e llojit dhe të vëllimit të shërbimeve shëndetësore ekzistuese, qëndrueshmëri financiare të institucioneve shëndetësore dhe nevoja për financim, për funksionimin e tyre, punësime të reja të kuadrit të specializuar si dhe për rritjen e pagave për kategori të caktuara të punëtorëve shëndetësorë”, tha Stefanovski.

Për institucionet shëndetësore publike janë siguruar rreth 13 miliardë dhe 800 milionë denarë, ndërsa për ato private janë siguruar 8 miliardë denarë. Rritje më të madhe të buxhetit, për vitin 2016 do të marrë spitali i përgjithshëm “8 shtatori” në Shkup dhe do të jetë 68,5 milionë denarë. Drejtori i FSSHM-së, Orhan Ramadani thotë se rritja e buxhetit është stimulues dhe motivues, me qëllim që të ofrohen më shumë shërbime shëndetësore, dhe njëkohësisht të sigurohen edhe shërbime shëndetësore më cilësore, raporton 21 nga Maqedonia.

Duke iu përgjigj pyetjes së gazetarit se në çka bazohet rritja e buxhetit, Stefanovski tha se kjo ndodh për shkak të punësimeve të reja në spitale dhe në institucionet tjera shëndetësore.

Gripi, numri më i madh i të sëmurëve në Tetovë

Shkup, 4 janar - Gjatë javës së 52-të të vitit 2015 (21.12 - 27.12.2015), në Republikën e Maqedonisë prej 12 njëjësive raportuese janë raportuar 131 raste të gripit me incidencë prej 6,3 në 100.000 banorë, që është për



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



20,2% më shumë se javën e kaluar. Numri i personave të raportuar gjatë kësaj jave është për 70,8% më i vogël me atë në javën e 51 të sezonit të kaluar kur janë regjistruar 449 raste.

Sipas Institutit të Shëndetit Publik, gjatë kësaj jave numri i rasteve tejkalon numrin 120 që shënon kufirin javor të aktivitetit sezonal të virusit të gripit. Kjo do të thotë se zyrtarisht kemi hyrë në sezonin e gripit, por përsëri ky numër është shumë më i vogël (për 59,2%) krahasuar me lakoren epidemike të gripit që pritej për këtë javë.

Shpërndarja e të sëmurëve nga gripi sezonal sipas javës së raportimit, lakore epidemike tipike e modeluar e pesë sezoneve të fundit, sezoni 2014/2015 dhe sezoni 2015/2016

Si edhe gjatë javës së kaluar, në javën e 52 numri më i madh i të sëmurëve (67) janë raportuar në grupmoshën 15-64 vjet, ndërsa morbiditetet më i lartë Mb(19,8/100.000) është regjistruar tek më të rinjtë – fëmijët në moshën 0-4 vjet.

Numri më i madh i të sëmurëve gjatë kësaj jave (30) janë regjistruar në territorin e QSHP Prilep, QSHP Tetovë-29 ndërsa në QSHP Kumanovë janë regjistruar 22 raste.

Incidencë më të madhe gjatë kësaj jave (42,2/100.000) është regjistruar në NJR Krushevë ku gjatë javës së 52 janë regjistruar 4 të sëmurë.

Numri i përgjithshëm i të sëmurëve për këtë sezon është 1.083, ndërsa incidenca kumulative –52,3 /100 000 banorë. Të sëmurë janë raportuar nga 20 njësi raportuese. Numër më i madh i të sëmurëve është raportuar nga QSHP Tetovë (339; 31,3%), QSHP Prilep (221; 21,4%) dhe QSHP Kumanovë(209; 19,3%),, ndërsa në rajonet e tjera është regjistruar numër më i vogël i rasteve. Incidencë më e madhe është vënë re në Krushevë 304,3/100.000 (29 të sëmurë).

Sa i përket shpërndarjes sipas grupmoshave, numër më të madh të të sëmurëve ka në grupmoshën 15-64 vjet – 692 (63,9%), ndërsa incidencë kumulative më të madhe prej 100,7/100.000 banorë është regjistruar tek fëmijët nga 0-4 vjet dhe ato të moshave shkollore nga 5-14 vjet (86,8/100.000 banorë).

Shpërndarja e të sëmurëve sipas muajve: tetor - 225 raste (20,8% e numrit të përgjithshëm të të sëmurëve), në nëntor - 431 raste ose 39,8%. Në dhjetori janë raportuar 427 raste ose 39,4% e numrit të përgjithshëm të të sëmurëve.

Këtë javë në ISHP janë pranuar 2 mostra biologjike për analizë për prani të virusit të gripit nga të cilat një është pozitive për prani të influencës B. Në sezonin 2015/2016 nga 28 mostrat e pranuar deri më tani, ka dy rezultate pozitive për prani të virusit të gripit – Influenca e tipit A dhe influenza B.

Duke filluar nga java e 42-të ka filluar vaksinimi kundër gripit sezonal. Sipas raportimeve të deritanishme, janë vaksinuar gjithsej 26.231 persona, ose 86,8% prej numrit të përgjithshëm të vaksinave të furnizuara për këtë sezon. Numri më i madh i personave të vaksinuar janë në moshë mbi 64 vjet – 60.2%, 34,9% persona në moshë nga 30-64 vjet, ndërsa grupmosha nga 5-29 vjet përbën 1.8% të të vaksinuarve. Janë vaksinuar 5 fëmijë nën moshën 5 vjeçare. Nuk ka gra shtatzëna të vaksinuar.



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Nga numri i përgjithshëm i të vaksinuarve 68.3% janë persona me sëmundje kronike. Gjatë këtij sezoni janë vaksinuar edhe 814 punonjës shëndetësor (3,1% e të vaksinuarve).

Nga numri i përgjithshëm i vaksinave të siguruara nga QSHP Veles, 480 janë dhënë për nevojat e përfaqësuesve të Ministrisë së mbrojtjes të cilët ruajnë kufirin jugor të vendit.

Gjatë javës së 52 ka arritur raport për vaksinim të personave në institucione shëndetësore private në Shkup (ISHP Medika). Janë vaksinuar 656 persona, nga të cilët numri më i madh janë fëmijë në moshë nga 0-4 vjet – 317 (48,3%), 150 (22,9%) janë persona në moshë mbi 65 vjet, ndërsa personat nga 30-64 vjet përbëjnë 20,1% (132) të të vaksinuarve dhe nga 5-29 vjet janë vaksinuar 57 persona (8,7%).

Nga numri i përgjithshëm, 164 (25%) janë me sëmundje kronike.

Vaksinimi ka përfunduar në NJR Demir Hisar , NJR Negotinë, SH. Nikollë, QSHP Koçan, NJR Dibër, QSHP Strumicë, NJR Vallandovë, dhe NJR Radovish.

Vaksinimi kundër gripit sezonal është mbrojtja më e mirë, prandaj Instituti i shëndetit publik rekomandon që të gjithë personat me sëmundje kronike dhe me imunitet të dobët të drejtohen pranë Qendrave të shëndetit publik ose Njësive rajonale për informacion dhe vaksinim kundër gripit sezonal.

Numri relativisht i vogël i rasteve të raportuara të gripit, i cili lëviz rreth kufijve të aktivitetit sezonal, si dhe rezultatet negative të fituara gjatë mbikëqyrjes virusologjike flasin për një aktivitet të ulët të virusit të gripit në Republikën e Maqedonisë.

Sipas informacioneve të prezantuara në Flu News Europe (për javën e 51), për gjendjen me gripin në sezonin 2015/2016 në Evropë, aktiviteti i virusit të influencës është me intensitet të ulët në pjesën më të madhe të vendeve në Evropë.

Edhe pse numri i rasteve të regjistruara, rritet përqindja e mostrave pozitive për grip nga 6% në javën 50 në 11% në javën 51. Rritja e numrit të mostrave pozitive është si rezultat i tipit A/H1N1pdm09 të gripit i cili zbulohet më shpesh se tipat A/H3N2 dhe virusit B të gripit.

Sindikata e klinikave dënon incidentin në Tetovë

Shkup, 4 janar – Sindikata e pavarur e qendrave klinike ka dënuar sulmin fizik dhe verbal ndaj mjekut dhe motrës kujdestare në repartin pediatrik në spitalin klinik të Tetovës. Ato bëjnë përsëri apel për një punë sa më efikase dhe profesionale si dhe mbrojtje të mjekëve.

“Sulmuesve të tillë në këtë rast duhet që t’iu shqyptohet masa dënimi që më pas në të ardhmen të mos përsëriten raste të ngjajshme pasi që kjo ndikon në sjelljen e personelit mjekësorë në kryerjen e punës së tyre humane”, thuhet në njoftim, transmeton Zhurnal.

Brenda dy muajve ky është sulmi i dytë pas atij që ndodhi në klinikën e Shkupit kur mjeku u qëllua me armë nga familjarët e pacientes.



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



ALSAT

Rritet numri i të prekurve nga gripi



Instituti i Shëndetit Publik ka njoftuar për rritjet e numrit të të prekurve nga gripi. 131 raste të reja janë shënuar, që është për 20 % më shumë se javën e kaluar. Numri i përgjithshëm i të sëmurëve për këtë sezon është 1.083. Numër më i madh i të prekurve është regjistruar në Tetovë, Prilep dhe Kumanovë. Deri tani janë vaksinuar mbi 26 mijë persona, numri më i madh i të cilëve janë mbi 64 vjeç. Instituti i Shëndetit Publik rekomandon që të gjithë

personat me sëmundje kronike dhe me imunitet të dobët të drejtohen pranë Qendrave të shëndetit publik ose Njësive rajonale për informacion dhe vaksinim kundër gripit sezonal.

Familja Limoni nga Shkupi në kushte të mjerueshme



Viti 2015 ishte i vështirë për shumë familje, në mesin e të cilave është edhe familja 7 anëtarëshe Limoni nga Shkupi e cila këto ditë të ftohta dimri po i kalon duke u ngrohur me pak dërrasa të mbledhura gjithandej rrugëve të Shkupit. Kryefamiljari Nehat Limoni duke rrëfyer për jetën skamnore tha se çdo ditë, duke nisur nga orët e pasdite e deri në mesnatë mbledh hekur, shishe plastike dhe letra për të mbajtur

familjen. Ai thotë se vështirësia më e madhe me të cilën përballet për momentin është mungesa e druve për ngrohje.

“Dal nga Qendra, këndej nga Topansko, Veri e Çair, mbledh shishe, hekur e dërrasa me u ngrohë se nuk kemi edhe dru, kemi mbet askund. Mbrëmë njëri mi dha 200 denarë, më pa më tha çka ke dal i thash ja po e sheh vet, mi dha 200 denarë tha bliju fëmijëve. Skena momentalisht dru, s’kena hiç, mos me than pa hiç, ndoshta kam edhe për nesër. Një metër kam pas mundësi me ble..s’kena mundësi, socialen e kemi të ndalur, të ardhura nuk kemi prej askund vetëm që na ndihmon dikush”, u shpreh Nehat Limoni, kryefamiljar.



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Për të zbutur sadopak varfërinë në këtë familje, fëmijët janë detyruar të dalin në rrugë për të shitur çokollata, edhe pse një gjë të tillë vazhdimisht kundërshtohet nga prindërit e tyre.

“Unë fëmijëve ju them mos dilni me shit se po i marin fëmijët, ata thonë e dimë qysh e kemi gjendjen patjetër me dal..prej zorit po del unë mendjen vazhdimisht e kam te ai derisa është në Pazar, ai vjen në ora 9 ose 10 të darkës, thotë oj mami jam lodhë, fle menjëherë...Krejt me skamje, kush me ka dhënë se kurrë unë nuk ju kam ble..Bie e ngrihesh tu mendu çka të përgatis për nesër, nuk ki, me pas e gjen zgjidhjen, kur nuk ki njeriu i then duart, vjen edhe dikush”, tha Havushe Limoni, bashkëshortja.

Fëmija më i vogël në këtë familje është 2 javësh. Familja Limoni nuk ka asnjë të ardhur të rregullt edhe asistencën sociale të cilën e merrnin deri në vitin 2013 iu ndërpre për shkak të një punësimi një mujor që kryefamiljari e kishte bërë në një kompani private.

Melihate Rustemi

Të interesuarit që dëshirojnë të ndihmojnë këtë familje mund të kontaktojnë në numrin e telefonit:

+389 75 567 601

Ose përmes xhirollogarisë:

Nehat Limoni

300007022149942 Komercijalna Banka, Shkup



Gruevksi paralajmëron rritje të ndihmës sociale



Kryeministri në largim Nikolla Gruevski ka paralajmëruar rritje të ndihmës sociale për pesë përqind...

Sipas tij, shfrytëzuesit e ndihmës sociale do të përfitojnë nga kjo rritje, filluar me pagesën e ndihmës sociale për muajin korrik.



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



“Edhe më herët paralajmërova, do të ketë rritje të ndihmës sociale edhe këtë vit, për pesë përqind. Rritja do të bëhet më pagesën për muajin korrik të vitit 2016. Deri tani, që kur jemi në pushtet kemi rreth 62% rritje të ndihmës socioale. Duke e rrit gradualisht për cdo vit. Me këtë rritje që do të ndodh në korrik për pesë përqind, rritja do të kalojë mbi 65%”, shprehet kryeministri Nikolla Gruevski.

PORTALB
dritare realiteti

Sindikata: Të mbrohen mjekët gjatë ushtrimit të detyrës



Sindikata e pavarur e mjekëve në Qendrën e klinikës kanë dënuar sulmin fizik ndaj mjekut kujdestar dhe infermieres në repartin për fëmijë në spitalin e Tetovës, njofton Portalb.

“Kryerësit e këtij incidenti dhe rasteve të ngjashme duhet t’u caktohen dënime, që në të ardhmen mos të ndodhin raste të këtilla, të mos sulmohen punëtorët në zbatimin e veprimtarisë së tyre humane”, thuhet në kumtesë./Portalb



Buxheti i Fondit për sigurim shëndetësor për vitin 2016



FONDI I SIGURIMIT
SHËNDETSOR TË MAQEDONISË
www.fzo.org.mk

Fondi për sigurim shëndetësor vitin 2016 do ta fillojë me një buxhet të rritur historik prej 25,6 miliard denarë. Krahasuar me vitin e kaluar, rritja shënon vlerën me 1,4 miliard denarë respektivisht, krahasuar me vitin 2000 kemi pothuajse rritje të dyfishtë.

Për shpërndarje të drejtë dhe transparente të buxhetit, dy muajt e kaluar kemi zhvilluar negocijatat me personelët e sistemit shëndetësor dhe kemi bërë shpërndarjen metodologjike mes Institucioneve shëndetësore publike dhe private. Negocijatat janë praktikuar në një mënyrë më ndryshe se herave tjera gjegjësisht, negocijatat janë mbajtur në hapësirat e vetë Institucioneve shëndetësore e disa prej tyre dhe në Fond. Për shpërndarjen e buxhetit, Fondi bazohet në



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



të dhënat e Institucioneve shëndetësore dhe në analizat e realizimit të buxhetit në vitin 2015, Planin për llojin dhe fushëveprimin e shërbimeve shëndetësore, metodat e reja, shërbimet e reja shëndetësore për vitin 2016 (për të cilat shërbime të siguruarit janë dërguar të mjekohen jashta vendin) si dhe qëndrueshmëria e Institucioneve shëndetësore publike.

Shpërndarja e përgjithshme e mjeteve për vitin 2016 qëndron si në vijim:

Shpenzimet	Mjetet për vitin 2016 (të shprehura në 000 denarë)	Përqindja
Institucionet shëndetësore publike	13,746,599	54 %
Institucionet shëndetësore private (prej të cilave):	7,813,500	31 %
Mjekët amë	2,785,000	
Barnatoret	2,480,000	
Specialistët dhe Laboratoritë	610,000	
Dijaliza	1,000,000	
In – vitro	95,000	
Kardiokirurgjia	705,000	
Kirurgjia e syve	65,500	
Banjat	73,000	
Mjekimet jashta vendit	300,000	1 %
Paisjet ortopedike	550,000	2 %
Refundimet	50,000	



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



MANU	17,000	
Kompenzimet e pushimeve mjekësore dhe të lindjes	2.575.000	10 %
Shpenzimet administrative të Fondit	573,078	2 %
Gjithsej	25,575,177	

Gjatë shpërndarjes së buxhetit për vitin 2016, rritjen e mjeteve prej 860 milion denarë u'a kemi dedikuar Institucioneve shëndetësore publike, duke ju dhënë përkrahje serioze dhe stimul më të madh.

Mjetet e dedikuara u përkasin disa segmenteve edhe atë:

- Shërbimeve të reja shëndetësore duke zbatuar metoda të reja për mjekim
- Rritjes së Llojit dhe fushëveprimit të shërbimeve shëndetësore egzistuese
- Qëndrueshmërisë financiare të Institucioneve shëndetësore dhe nevojës së financimit për funksionim
- Punësimeve të reja të stafit të specializuara
- Rritjes së pagave për të punësuarit mjekësor që u përkasin kategorive të caktuara

Shpërndarja e buxhetit nëpër Institucionet shëndetësore publike është përcaktuar si në vijim:

Nr	Lloji i shëndetësore	Institucioneve GJITHSEJ	Buxheti për vitin 2015	Buxheti për vitin 2016	Dallimi mes Buxhetit 2016 dhe 2015	Përqindja e rritjes %
1	Klinikat Universitare		4.559.342.000	4.820.242.000	260.900.000	5,72
2	Klinikat Spitalore, dhe Spitalet e përgjithshme		4.263.100.000	4.631.500.000	368.400.000	8,64
3	Spitalet speciale		1.144.200.000	1.202.400.000	58.200.000	5,09
4	Shtëpitë e shëndetit dhe Stacionet		2.036.398.000	2.129.598.000	93.200.000	4,58
5	Institutet dhe Fakulteti I mjekësisë		690.800.000	731.400.000	40.600.000	5,88



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



6	Qendrat e shëndetit publik	192.900.000	211.100.000	18.200.000	9,43
7	Qendra PET[1]		20.500.000	20.500.000	
	Gjithsej Institucionet shëndetësore publike	12.886.740.000	13.746.740.000	860.000.000	6,67353

Këtë vit për herë të parë ndajmë mjete për funksionimin e Insitucionit të ri shëndetësor, Qendra PET i cili do të ketë rëndësi të madhe në sistemin shëndetësor.

Rritja e buxhetit për Institucionet shëndetësore publike është motivuese me qëllim që të rritet vëllimi dhe kualiteti i shërbimeve shëndetësore. Rritja e mjeteve është e kushtëzuar me rritjen e numrit të intervenimeve kirurgjikale tek Klinikat dhe Spitalet e përgjithshme, duke synuar zvogëlimin e udhëzimeve që jepen drejt Klinikave të kryeqytetit.

Në vijim do të veçojmë disa nga Institucionet shëndetësore publike me buxhet të rritur:

Klinika Universitare e Kardiologjisë ka rritje prej 19,4 milion denarë respektivisht buxhet të përgjithshëm prej 342,4 milion denarëve;

Klinika Universitare për Neurokirurgji ka rritje prej 9,9 milion denarë, buxhet të përgjithshëm prej 122,9 milion denarëve;

Klinika Universitare për Kirurgji torakale dhe vaskulare ka rritje prej 6,9 milion denarë, buxhet të përgjithshëm prej 112,4 milion denarëve;

Klinika universitare për traumatologji, sëmundje ortopedike, anestezion, reanimacion dhe mjekim intenziv-Qendra e urgjencës ka rritje prej 49,4 milion denarë, buxhet të përgjithshëm prej 443,9 milion denarëve;

Klinika universitare për hematologji ka rrite prej 19,9 milion denarë, buxhet të përgjithshëm prej 247,4 milion denarëve;

Klinika Universitare për radioterapi dhe onkologji ka rritje prej 24,4 milion denarë, buxhet të përgjithshëm prej 576,4 milion denarëve

Prej Spitaleve do ta veçojmë 8 Shtatorin me rritje prej 68,9 milion denarë, buxhet të përgjithshëm prej 829,9 milion denarëve;

Spitali Klinik i Shtipit ka rritje prej 19,9 milion denarë, buxhet të përgjithshëm prej 338 milion denarëve

Spitali Klinik i Manastirit ka rritje prej 19,9 milion denarë, buxhet të përgjithshëm prej 602 milion denarëve

Spitali Klinik i Tetovës ka rritje prej 29.9 milion denarë, buxhet të përgjithshëm prej 460 milion denarëve

Spitali i përgjithshëm Kumanovë ka rritje prej 48,9 milion denarë, buxhet të përgjithshëm prej 371,4 milion denarëve.

Spitali i përgjithshëm Gostivar ka rritje prej 45,9 milion denarë, buxhet të përgjithshëm prej 285,5 milion denarëve.

Spitali Klinik i Tetovës, Spitali i përgjithshëm Kumanovë dhe Spitali i përgjithshëm Gostivar kanë gjithsej rritje prej 123,7 milion denarë ose mbi 2 milion euro, respektivisht buxhet të përgjithshëm prej 1 miliard e 120 milion denarë.

Buxheti i mbetur prej 1,4 miliard denarë (540 milion denarë) shpërndahet për furnizimin e barnatoreve me barna që jepen me receta, për rritjen e numrit të trajtimeve për dijalizë, për rritjen e numrit të procedurave in-vitro dhe lirimimin nga participimi i procedurës in-vitro që hyri në fuqi nga 13 Nëntori 2015, si dhe rritja e vlerës së kapitacionit të mjekëve të përgjithshëm amë dhe stomatologëve amë.

[1] Qendra për Tomografi të Emisionit Pozitron (Positron Emission Tomography)



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Kapacitete të dobëta kundër ndotjes



Mungesa e të dhënave të sigurta dhe gjithëpërfshirëse për substancat ndotëse dhe ndotësit, mungesa e sistemit të integruar në zgjidhjen e problemeve të ambientit jetësor, sidomos në menaxhimin me resurset ujore dhe të mbeturinave, si dhe mungesa e investimeve kapitale për financimin e infrastrukturës në këto fusha, në mënyrë shtesë e ngadalësojnë vendosjen e sistemit efikas për mbrojtjen e ambientit jetësor në Maqedoni, vlerësohet në publikim

Fisnik PASHOLLI

Mungesa e të dhënave të sigurta dhe gjithëpërfshirëse për substancat ndotëse dhe ndotësit, kapacitetet e dobëta për implementimin e ligjeve të ambientit jetësor në nivel qendror dhe lokal, bartja e kompetencave për mbrojtjen e mjedisit tek komunat dhe mungesa e mjeteve financiare për realizimin e këtyre obligimeve, janë disa nga problemet kryesore të mbrojtjes së ambientit në Maqedoni. Sipas publikimit të fundit të Entit të Statistikës së Maqedonisë “Ambienti jetësor 2015”, të cilën ky institucion e ka përgatitur në bashkëpunim me Ministrinë e Ambientit jetësor dhe planifikimit hapësinor, problemet e kësaj natyre në Maqedoni janë të ngjashme me ato të shteteve të rajonit. Publikimi ka identifikuar problemet e shumta dhe mangësitë përmes projekteve të ndryshme, studimeve dhe dokumenteve planifikuese.

“Mungesa e të dhënave të sigurta dhe gjithëpërfshirëse për substancat ndotëse dhe ndotësit, mungesa e sistemit të integruar në zgjidhjen e problemeve të ambientit jetësor, sidomos në menaxhimin me resurset ujore dhe të mbeturinave, si dhe mungesa e investimeve kapitale për financimin e infrastrukturës në këto fusha, në mënyrë shtesë e ngadalësojnë vendosjen e sistemit efikas për mbrojtjen e ambientit jetësor në Maqedoni”, vlerësohet në publikim. Analiza e pestë me radhë e Entit të Statistikës thekson dobësitë themelore të zgjidhjes së problemeve të ambientit jetësor në Maqedoni, të cilat pas miratimit të shumicës së ligjeve të harmonizuara me legjislacionin e BE-së, akoma kanë nevojë për forcimin e vazhdueshëm të kapaciteteve dhe sigurimit të mekanizmave për monitorim dhe realizim të ligjeve si në nivel lokal ashtu edhe në atë nacional. Problemet me mjedisin jetësor janë akoma të mëdha për shkak të mungesës së lidhjes funksionale ndërmjet nivelit lokal dhe nacional në aspekt të kompetencave dhe detyrave që kanë marrë njësitë e vetëqeverisjes lokale, thekson më tej analiza për mbrojtjen e mjedisit jetësor në Maqedoni gjatë vitit 2015. Gjithashtu, nënvizohet problemi i kapaciteteve të dobëta të komuna, sidomos në menaxhimin me mbeturinat komunale, kompletimi i sistemit nacional për ambient jetësor, vendosja e inspeksioneve lokale, zbatimi i ligjeve, lëshimi i lejeve “B” të integruara si dhe kompetencat e tjera në përputhje me kërkesat e BE-së dhe nevojat lokale. Ekziston nevoja shtesë për trajnim të administratës qendrore dhe lokale me qëllim të përshpejtohet procesi i tranzicionit dhe të sigurohet koordinim adekuat vertikal ndërmjet organeve. Është evidente se akoma një pjesë e madhe kompetencave janë në duart e administratës qendrore, dhe atë jo ligjërish, por praktikisht. Kjo gjendje i detyrohet mungesës së mjeteve lokale financiare për mjedisin dhe kërkesave të vazhdueshme për plotësimin e këtyre vrimave nga ana e buxhetit qendror. Mungojnë sistemet rajonale të integruara për menaxhimin me mbeturinat e forta komunale dhe sistemi për menaxhimin me llojet



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



e veçanta të mbeturinave, përfshi edhe mbeturinat e rrezikshme. Ekziston mbulimi i pamjaftueshëm i vendbanimeve dhe komunave me sistem për grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të zeza (sidomos për ato mbi 10 mijë banorë), ndërsa duhet të vendoset e menaxhimi i integruar me pellgun apo rrjedhën e lumenjve në bazë të Ligjit të ri për ujëra. Ndotja e ajrit me intensitet të ndryshëm në pjesë të ndryshme të vendit, ndërsa kontaminimi i truallit rezulton me prodhimin e prodhimeve bujqësore me cilësi joadekuate nga hapësirat me truall të kontaminuar. Ekziston edhe problemi me sigurimin e menaxhimit adekuat të trashëgimisë natyre, ku me përjashtim të parqeve nacionale të Pelisterit, Mavrovës dhe Galiciçës dhe disa përmendoreve të natyrës, për objektet e tjera të natyrës akoma mungojnë subjekte për menaxhimin e tyre. Sfidë paraqet edhe vendosja e financimit të qëndrueshëm të hapësirave të mbrojtura. Publikimi thekson edhe masat për tejkalimin e dobësive në zgjidhjen e problemeve të ambientit jetësor, si rritja e kapaciteteve dhe investimi në kapitalin njerëzor. Proceset e aderimit në BE-së dhe vendosja e zhvillimit të qëndrueshëm, me theksim të fuqishëm të nevojës së përforcimit të përgjithshëm të sistemit nacional të menaxhimit me ambientin jetësor dhe përforcimi i kapaciteteve të administratës në nivel lokal dhe qendror për implementimin e legjislacionit nacional në fushën e ambientit jetësor, mbeten prioritetet kryesore. Në këtë drejtim nevojitet të zbatohen masat për sigurimin dhe forcimin e kapacitetit dhe strukturave institucionale të nevojshme për proces të përsheptuar të identifikimit, përgatitjes dhe implementimit të programeve dhe projekteve sipas kërkesave të fondeve paraqasëse evropiane, si dhe përkrahjes tjetër të disponueshme bilaterale dhe multilaterale. Nga ana tjetër, decentralizimi imponoi identifikimin e prioritetëve të shumta dhe aksioneve të dedikuara për lehtësimin e procesit të bartjes së kompetencave nga niveli qendror në nivelin lokal. Andaj u vendos theksi edhe në përforcimin e strukturave rajonale dhe lokale, me të cilat Maqedonia do të përgatitet për implementimin e rregullativës, por edhe për shfrytëzimin e tërësishëm të fondeve evropiane. Në këtë kontekst, masat duhet të jenë në drejtim të ndihmës për fuqizimin e sistemit të decentralizuar për menaxhimin me projektet, identifikimin e resurseve njerëzore të nevojshme për përgatitjen dhe realizimin e projekteve investuese në nivel qendror dhe lokal, përforcimin e kapaciteteve të tyre dhe formimin e sektorëve dhe departamenteve në nivel qendror dhe lokal për përforcimin e sektorëve për përgatitjen dhe realizimin e projekteve infrastrukturore me punësime të reja.

Rritet numri i të prekurve nga gripi



Instituti i Shëndetit Publik ka njoftuar për rritjet e numrit të të prekurve nga gripi. 131 raste të reja janë shënuar, që është për 20 % më shumë se javën e kaluar. Numri i përgjithshëm i të sëmurëve për këtë sezon është 1.083.

Numër më i madh i të prekurve është regjistruar në Tetovë, Prilep dhe Kumanovë. Deri tani janë vaksinuar mbi 26 mijë persona, numri më i madh i të cilëve janë mbi 64 vjeç.

Instituti i Shëndetit Publik rekomandon që të gjithë personat me sëmundje kronike dhe me imunitet të dobët të drejtohen pranë Qendrave të shëndetit publik

ose Njësi rajonale për informacion dhe vaksinim kundër gripit sezonal.